



FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI IFAQE 4-5

NDËRKOMBËTARËT DUAN VAZHDIMIN E KËSAJ QEVERIE

Analisti politik Ramush Tahiri ka vlerësuar se ndërkombëtarët duan që qeveria Hoti ta vazhdojë punën. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se dëshira e të huajve ka të bëjë me atë se Kosova është në gjysmë të disa proceseve të rëndësishme. Tahiri ka vlerësuar se për të ndodhur kjo subjektet politike duhet ta gjejnë një konsensus për zgjedhjen e presidentit të ri. Sipas tij, zgjedhja e presidentit të ri do të garantonte stabilitet institucional edhe nëse vendi shkon në zgjedhje të reja



AKTUALE



META THOTË SE QEVERIA E SHQIPËRISË DUHET TA BËJË MAKSIMUMIN NË LUFTËN ME PANDEMINË F. 2

PËRVEÇ LV-SË, PARTIVE TË TJERA "NUK U KONVENOJNË ZGJEDHJET" F. 6

KOSOVA REGJISTRON EDHE 14 VIKTIMA DHE 519 RASTE TË REJA ME COVID F. 3

EKONOMI



PROJEKTIGJI I PUNËS SË SHPEJTI DËRGOHET NË KUVEND F. 8

BSPK-ja: LIGJI PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE ËSHTË DISKRIMINUES PËR DISA SEKTORË F. 9

SPORT

MBI 43 MIJË LIBRA PËR BIBLIOTEKAT E SHKOLLAVE TË LIPJANIT F. 10



KOSOVA APLIKON ZYRTARISHT PËR VAKSINËN KUNDËR COVID-19

IFAQE 3



Kosova është listuar në mesin e shteteve që 20 për qind të vaksinës kundër Covid-

19 do ta marrë falas përmes aleancës globale GAVI-COVAX, kurse pjesën tjetër

do ta blejë vetë. Ndërkaq aplikimi për asistencë teknike është bërë ditë më parë

GJILANI DO TA NDIHMOJË BASHKINË E LEZHËS PËR SANIMIN E PASOJAVE NGA TËRMETI

IFAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin, Kosov,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Meta thotë se Qeveria e Shqipërisë duhet ta bëjë maksimumin në luftën me pandeminë

TIRANË, 7 DHJETOR (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka shprehur shqetësimin e tij për situatën e vendit për shkak të pandemisë Covid-19. Ai ka theksuar se duhet të ketë një organizim të fortë dhe të merren masa të menjëhershme që pacientët të mos presin më në autoambulanca për ta marrë shërbimin e duhur. Sipas Metës, qeveria duhet të bëjë maksimumin në këtë luftë me pandeminë, duke mos kursyer financimet e nevojshme dhe mobilizimin e organizuar të të gjitha resurseve njerëzore për përballimin e saj. "Shpreh shqetësimin e thellë për përshkallëzimin e situatës së pandemisë Covid-19. Rastet e shtuara të humbjeve së jetëve, si dhe të qytetarëve të infektuar, përbëjnë një

preokupacion madhor. Shtimi i urgjencave me qytetarë të prekur nga Covid-19 në gjendje të rëndë, të cilët vijnë drejt spitaleve të Tiranës dhe detyrohen të presin gjatë në autoambulanca, kërkojnë marrjen e masave të menjëhershme, që kjo situatë të mos përsëritet. Kërkohej një organizim i fortë, që u jep përgjigje të menjëhershme problemeve të shumta dhe shpesh të dhimbshme të qytetarëve lidhur me Covid-19. Çdo ankesë e qytetarëve duhet trajtuar me përgjegjësi maksimale dhe në mënyrë urgjente, pasi çdo vonesë rrezikon jetë dhe kjo është e papranueshme. Qeveria duhet ta bëjë maksimumin në këtë luftë me pandeminë, duke mos kursyer financimet e



nevojshme dhe mobilizimin e organizuar të të gjitha resurseve njerëzore për

përballimin e saj. Covid-19 është një armik i rrezikshëm dhe duhet trajtuar si i tillë, me

qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së çdo qytetari", ka thënë Meta.

Merr detyrën qeveria e re e Malit të Zi



Podgoricë, 7 dhjetor - Qeveria e re e Malit të Zi, e cila për herë të parë pas gati tri dekadash nuk është formuar nga Partia Demokratike e Socialistëve, mori detyrën të hënën. Kryeministri i deritashëm, Dushko Markoviq, konfirmoi në llogarinë e vet në "Twitter", se i ka dorëzuar detyrën kryeministrit të ri, Zdravko Krivokapiq. "Shpresojmë se kjo qeveri do të punojë në interes të Malit të Zi dhe të gjithë qytetarëve të tij", ka thënë Markoviq.

Kryeministri i ri, Krivokapiq, dhe kabineti i tij, i cili përbëhet nga 12 ministra dhe një zëvendëskryeministër, ku këtë post do ta ushtrojë Dritan Abazoviq, janë zgjedhur në një seancë të Kuvendit të Malit të Zi më 4 dhjetor. Ata i kanë mbështetur 41 deputetë nga gjithsej 81. Qeveria e re përbëhet nga tre koalicionet, ndërsa dominohet nga partia Fronti Demokratik, e cila cilësohet si pro-serbe. Partia Demokratike e Socialistëve, e cila udhëhiqet

nga presidenti Millo Gjukanoviq, i ka humbur zgjedhjet e 30 gushtit për herë të parë në gati 30 vjet. Dritan Abazoviq ka njoftuar për marrjen e detyrës së re përmes një njoftimi në llogarinë e vet në "Facebook". "Unë mora detyrën e zëvendëskryeministrit të Malit të Zi. Qëllimi im është të punoj me ndershmëri dhe në interes të qytetarëve", ka shkruar Dritan Abazoviq. Partia e Abazoviqit ka katër deputetë në Parlamentin e Malit të Zi.

Topalli përjashton bashkëpunimin me Bashën, Metën dhe Ramën

TIRANË, 7 DHJETOR - Ish-kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, në emisionin "Top Talk", udhëhequr nga gazetari Denis Dyrnjaja, ka folur për partinë e saj Lëvizja për Ndryshim dhe për zhvillimet politike në Shqipëri. Topalli është përgjigjur shumë e prerë nëse do të kishte bashkim votash me ndonjë nga partitë e vendit. Ajo ka treguar se s'do të ndodhë asnjë koalicion me Ilir Metën, Edi Ramën apo Lulzim Bashën.

"Lëvizja për Ndryshim është kundër tre kryetarëve të korruptuar, Ilir Metës, Edi Ramës dhe Lulzim Bashës. Heshtja e shumë njerëzve po përkthehet me votë. Ata kanë një vetëdije politike dhe dinë të mendojnë për familjen e njerëzit. Gjatë kësaj periudhë ka një fenomen, politika e mbylljes, e moshapjes apo e përçarjes, por ne duhet ta ndryshojmë këtë", ka thënë Topalli. Ajo është shprehur e indinjuar nga Partia Demokratike nën

drejtimin e Lulzim Bashës, duke theksuar se ky i fundit tradhtoi në radhë të parë anëtarët e partisë dhe më pas edhe vendin e tij. Ish-numri dy i PD-së tha prerë se për sa kohë Basha do të jetë në opozitë, kryeministri Edi Rama do të jetë në krye të vendit. Topalli ka thënë se Lëvizja për Ndryshim do ta sjellë shpresën në Shqipëri dhe, sipas saj, synimi kryesor i kësaj lëvizje është rrëzimi i tri figurave kryesore prej shumë vitesh në politikën shqiptare.



Anulohet tenderi për ndërtimin e autostradës Milot - Fier

TIRANË, 7 DHJETOR - Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë në Shqipëri ka anuluar tenderin për projektimin dhe ndërtimin e rrugës Milot - Fier. Vendimi është marrë pak ditë

më parë dhe është botuar në faqen e Agjencisë së Prokurimeve Publike. Projekti me vlerë 1.18 miliardë dollar është anuluar me arsyetimin se oferta e paraqitur nuk

përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Rruga është parashikuar të jetë 115 kilometra, autostradë e kategorisë A dhe sipas projektit

duhej të ndërtohej nga privatët në formën e një koncensionit. Gara për këtë rrugë u hap më 1 korrik përmes një ceremonie, ku ishin të pranishëm krerët e shtetit.

Kosova aplikon zyrtarisht për vaksinën kundër Covid-19

Kosova është listuar në mesin e shteteve që 20 për qind të vaksinës kundër Covid-19 do ta marrë falas përmes aleancës globale GAVI-COVAX, kurse pjesën tjetër do ta blejë vetë. Ndërkaq aplikimi për asistencë teknike është bërë ditë më parë

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka nënshkruar të hënën aplikimin zyrtar për sigurimin e vaksinës kundër Covid-19 në aleancën globale GAVI-COVAX, kurse aplikimi për asistencë teknike lidhur me këto vakcina është bërë ditë më parë përmes ekipit të ekspertëve, i themeluar me qëllim të sigurimit të kësaj vakcine.

Përpos aplikimit zyrtar në GAVI-COVAX, nuk do të thotë se Kosova nuk do të shfrytëzojë edhe rrugë të tjera për të siguruar vakcina shtesë, sipas nevojës, përtej shifrës së 20 për qind të vaksinave që do të merren falas (apo rreth 360 mijë vakcina) nga COVAX, meqë synimi është të imunizohen kategoritë më të ekspozuara dhe të rrezikuara nga Covid-19. Synimi është që të vaksinohen grupet e popullatës që janë më të ekspozuara dhe rrezikuara nga Covid-19, siç janë nëpunësit shëndetësorë, të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike, personat i

shërbimeve të angazhuara për menaxhimin e situatës epidemiologjike lidhur me Covid-19, pa e përjashtuar asnjë kategori që duhet të vaksinohet kundër Covid-19.

Duke njohur faktin se sigurimi i vaksinave përbën një obligim ligjor për ruajtjen e shëndetit publik të popullatës, Ministria e Shëndetësisë qysh para disa muajve kishte vendosur kontakte me GAVI-COVAX, me qëllim që ta sigurojë vaksinën për qytetarët.

Pjesë e GAVI-COVAX, përveç OBSH-së, UNICEF-it, Bankës Botërore janë edhe fondacionet e ndryshme të fuqishme si dhe industria e vaksinave. Kjo organizatë ka marrë përsipër që të ndihmojë shtete me të ardhura të ulëta dhe të mesme për sigurimin e vaksinës.

Kosova është e listuar në mesin e shteteve që 20 për qind të vaksinës kundër Covid-19 do ta marrin falas përmes aleancës globale GAVI-COVAX, kurse pjesën tjetër do ta blejë vetë. Shumë kompani të prodhimit të vaksinave janë në përpjekje serioze për të zhvilluar dhe prodhuar vaksinën kundër



Covid-19 si mënyra më e mirë për t'i dhënë fund pandemisë globale.

Shtete si Britania e Madhe veç kanë paralajmëruar vaksinimin e shpejtë të grupeve të rrezikut me vaksinën anti-Covid, të njerit nga prodhuesit që tashmë ka marrë aprovimin për vaksinën e tij për përdorim te njerëzit.

Shtete të tjera janë në procedura të sigurimit të tyre qoftë përmes kontakteve të drejtpërdrejta, qoftë përmes organizatave e aleancave të ndryshme që merren me lehtësimin e qasjes në vakcina

në nivel global.

Disa nga shtetet me ekonomi të zhvilluara, përfshirë edhe industrinë farmaceutike, i kanë prodhuesit e tyre të vaksinave dhe kjo paraqet përparësi për to. Meqë procesi i sigurimit të vaksinës kërkon edhe disa parakushte të tjera që lidhen me transportin e tyre, ruajtjen, sigurinë dhe shpërndarjen e sigurt, Kosova ka aplikuar më parë për asistencë teknike në GAVI COVAX, ndërkohë që aplikimin për sigurimin e vaksinave shtesë e ka bërë zyrtarisht gjatë ditës së sotme, edhe pse afati ka qenë deri më

10 dhjetor. Ndërkaq asistencë teknike është kërkuar rreth zinxhirit të transportit dhe ruajtjes së vaksinave dhe sigurisë së saj.

Ekipi i ekspertëve i formuar me qëllim që të merret me çështjen e vaksinës ka edhe pikën fokale në këtë GAVI-COVAX përmes së cilës do të zhvillohen kontaktet e mëtejme deri në marrjen dhe administrimin e vaksinës te popullata.

Ndërkaq gjatë vitit MSh-ja dhe IKShPK-ja kanë punuar me ekspertë të huaj për ta dizajnuar zinxhirin e ftohtë të ri të ruajtjes së vaksinave në Kosovë.

Kosova regjistron edhe 14 viktima dhe 519 raste të reja me Covid

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 407 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 519 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 14 raste të të vdekurve me këtë virus.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjakovë katër raste (75, 66, 61, 36 vjeç), Podujevë një rast (68 vjeç), Prizren një rast (58 vjeç), Podujevë një rast (68 vjeç), Malishevë një rast (63), Ferizaj një rast (67 vjeç), Mitrovicë një rast (79 vjeç), Vushtrri një rast (70 vjeç), Shtime një rast (58 vjeç), Kaçanik një rast (65 vjeç),

Kamenicë një rast (72 vjeç), Suharekë një rast (68 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 43 324 raste nga 154 084 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 120 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 926 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 29 430 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 12 774.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 215 raste, Mitrovicë 49 raste, Ferizaj 33 raste, Podujevë 33 raste, Gjakovë 30 raste, Fushë-Kosovë 25 raste, Pejë 21 raste, Drenas 15 raste, Lipjan 14 raste, Obiliq 9 raste, Vushtrri 9 raste, Istog 7 raste, Klinë 7 raste, Prizren 7 raste, Shtime 7 raste, Skenderaj 7 raste, Kaçanik 6 raste, Suharekë 5 raste, Rahovec 4 raste, Deçan 3 raste, Gjilan 3 raste, Graçanicë 3 raste, Malishevë 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Dragash, Junik, Kamenicë, Viti 1 rast dhe Zubin-Potok.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, RAMUSH TAHIRI

NDËRKOMBËTARËT DUAN VAZHDIMIN E KËSAJ QEVERIE

Analisti politik Ramush Tahiri ka vlerësuar se ndërkombëtarët duan që qeveria Hoti ta vazhdojë punën. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se dëshira e të huajve ka të bëjë me atë se Kosova është në gjysmë të disa proceseve të rëndësishme. Tahiri ka vlerësuar se për të ndodhur kjo subjektet politike duhet ta gjejnë një konsensus për zgjedhjen e presidentit të ri. Sipas tij, zgjedhja e presidentit të ri do të garantonte stabilitet institucional edhe nëse vendi shkon në zgjedhje të reja

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Analisti politik Ramush Tahiri ka bërë me dije se ndërkombëtarëve u konvenon zgjedhja e presidentit në këtë kohë. Ai ka thënë se kjo do t'i mundësonte qeverisë Hoti vazhdimin e punës në mënyrë stabile. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Tahiri ka vlerësuar se ndërkombëtarët duan që kjo

qeveri ta vazhdojë punën për disa arsye. “Mendoj se ndërkombëtarëve u konvenon që partitë tani ta zgjedhin presidentin dhe të ndodhë vazhdimi i punës së kësaj qeverie në mënyrë që të kemi një stabilitet të paktën për një vit a më shumë. Ndërkombëtarët këtë qeveri e shohin si teknokratike, prandaj u konvenon. Pra, meqenëse Kosova ka mbetur në gjysmë të disave procese, jo vetëm të

liberalizmit të vizave, por edhe të proceseve të tjera siç është dialogu me Serbinë, atëherë ata do të donin që ta vazhdojë punën kjo qeveri”, ka thënë Tahiri.

Ai ka treguar se konsensusi i partive politike për ta zgjedhur presidentin e ri do të siguronte stabilitet institucional. Sipas Tahirit, nuk do të ishte mirë që vendi të shkojë në zgjedhje me ushtrues detyre të postit të presidentit. “Dëshiroj që kjo


tryezë të ketë sukses dhe partitë politike të bëjnë një konsensus për zgjedhjen e presidentit të ri. Zgjedhja e presidentit do të siguronte stabilitet politik edhe nëse vendi do të shkonte në zgjedhje të reja. Pra, nuk do të ishte e njëjta situatë sikurse vendi të shkojë në zgjedhje me ushtrues të detyrës së presidentit”, ka deklaruar Tahiri.

Ai ka treguar edhe cilave parti do t'u konvenonte mbajtja e zgjedhjeve të reja. “Në këto zgjedhje PDK-ja do të mund të rritej pak sepse, për shkak të burgosjes nga Haga të Thaçit dhe Veselit, njerëzit do të solidarizoheshin me luftën. Lëvizja Vetëvendosje mund të rrinte në këtë nivel apo mund të rritej, por duke ia marrë LDK-së votuesit. AAK-ja do të

mbetëj pak a shumë si parti lokale në Dukagjin, kurse Nisma do të humbte krejt”, ka deklaruar Tahiri.

“Epoka e re”: LDK-ja ka paralajmëruar një tryezë të partive për të diskutuar rreth zgjedhjes së presidentit të ri. Si e keni parë këtë iniciativë?

Tahiri: Është një iniciativë e mirë. Këtë iniciativë mund ta marrë jo vetëm LDK-ja që është parti në pushtet, por edhe LV-ja që është në opozitë. Ky është një forum partiak, i cili aktivizohet sa herë shihet nevoja për të gjetur një konsensus për ndonjë çështje të rëndësishme. Motivi i kësaj tryeze është zgjedhja e presidentit të Republikës së Kosovës. Siç dihet, presidenti nuk mund të zgjedhet pa qenë



të pranishëm 2/3 e deputetëve në Kuvend, përkatësisht 80 deputetë. Ani pse në raundin e tretë ai mund të zgjedhet me 61 vota, por kuorumi çdoherë duhet të jetë me 80 deputetë në sallë. Pra, kjo iniciativë është e vonuar sepse ka kaluar më tepër se një muaj nga dorëheqja e presidentit.

“Epoka e re”: Pse e konsideroni iniciativë të vonuar?

Tahiri: Prej dorëheqjes së presidentit për t'u zgjedhur president i ri duhen dy muaj. Pra, presidenti duhet të zgjedhet konform nenit 82 të Kushtetutës deri më 5 janar. Nëse nuk zgjedhet presidenti deri më 5 janar, atëherë duhet të shpërndahet Kuvendi dhe vendi të shkojë në zgjedhje brenda 45-ditësh. Pra, i bie që nëse partitë nuk merren vesh deri më 5 janar, vendi shkon në zgjedhje në muajin shkurt. Sipas asaj që unë e interpretoj Kushtetutën, presidenti i vendit duhet të zgjedhet në afat prej dy muajve, pra nga data e dorëheqjes e jo brenda gjashtë muajve qysh po thonë disa.

“Epoka e re”: Pritni që në këtë tryezë të arrihet ndonjë konsensus?

Tahiri: Dëshiroj që kjo tryezë të ketë sukses dhe partitë politike të bëjnë një konsensus për zgjedhjen e presidentit të ri. Zgjedhja e presidentit do të siguronte stabilitet politik edhe

nëse vendi do të shkonte në zgjedhje të reja. Pra, nuk do të ishte e njëjta situatë sikurse vendi të shkojë në zgjedhje me ushtrues të detyrës së presidentit.

“Epoka e re”: PDK-ja dhe AAK-ja publikisht kanë shprehur pretendimet e tyre për këtë post. Sa e vështirëson kjo procesin e zgjedhjes së presidentit?

Tahiri: Pretendimet e partive për këtë post politik janë të natyrshme. Pavarësisht se kush pretendon këtë post, Kushtetuta thotë se kandidatët për president duhet t'i kenë nga 30 nënshkrime të deputetëve. As Ramush Haradinaj dhe askush tjetër nuk e ka nisur procedurën e mbledhjes së nënshkrimeve për të qenë kandidat për president. Pra, sipas Kushtetutës, duhet të jenë dy kandidatë për president dhe ata duhet t'i kenë nga 30 nënshkrime. Tash partitë politike po bëjnë politikë me këtë çështje duke e kushtëzuar njëra-tjetrën. Në kushtet aktuale, nëse LV-ja dhe AAK-ja nuk bashkëpunojnë për ta zgjedhur presidentin, atëherë vendi mund të shkojë në zgjedhje. Në bazë të gjendjes aktuale, mendoj se presidenti duhet të zgjedhet prej LV-së ose prej PDK-së. Por, siç e dimë, LV-ja është e interesuar të shkojë në zgjedhje, kurse PDK-ja dëshiron ta këtë kandidatit vet,

pastaj të shkohet në zgjedhje.

“Epoka e re”: E shihni ju ndonjë skenar që presidenti i ri të zgjedhet para mbajtjes së zgjedhjeve nacionale?

Tahiri: Nëse AAK-ja lëshon pe dhe e kërkon një ministri më shumë, atëherë PDK-ja me siguri se do ta përkrahte qeverinë duke e nënshkruar një marrëveshje me partitë në pushtet për të mos e rrëzuar qeverinë deri në mandatin e saj kushtetues, me kushtin që koalicioni qeverisës ta zgjedhë kandidatit e PDK-së për president. Në këtë mënyrë PDK-ja do të stabilizohej, sepse do ta ketë për pesë vjet presidentin, ndërsa qeveria stabilizohet nga rreziku i rrëzimit të saj. Pa PDK-në kjo qeveri nuk mund të rrëzohet, sepse dihet se tri qeveritë e fundit janë rrëzuar me PDK-në. LV-ja do të ishte e pakënaqur me këtë, ndërsa LDK-ja do të priste të shihte nëse Vjosa Osmani do të formojë parti, në mënyrë që ta shikojë mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të brendshme.

“Epoka e re”: Nëse nuk do të ketë kompromis për president, kujt do t'i konvenonin zgjedhjet, sipas jush?

Tahiri: Në këto zgjedhje PDK-ja do të mund të rritej pak sepse, për shkak të burgosjes nga Haga të Thaçit dhe Veselit, njerëzit do të solidarizoheshin

me luftën. Lëvizja Vetëvendosje mund të rrinte në këtë nivel apo mund të rritej, por duke ia marrë LDK-së votuesit. AAK-ja do të mbetej pak a shumë si parti lokale në Dukagjin, kurse Nisma do të humbte krejt. Mirëpo nëse shkojmë tash në zgjedhje pa e zgjedhur presidentin, jam i sigurt se pas zgjedhjeve nuk do të mund të formohet koalicioni i ri qeverisës, sepse me LV-në nuk do të shkonin partitë aktuale dhe ajo nuk do të mund ta formonte qeverinë e vetme. Në këtë mënyrë vendi do të detyrohej të shkonte në zgjedhje edhe një herë në muajin maj.

“Epoka e re”: Shihni si mundësi që në këtë situatë të ndërhyjnë ndërkombëtarët?

Tahiri: Mendoj se ndërkombëtarëve u konvenon që partitë tani ta zgjedhin presidentin dhe të ndodhë vazhdimi i punës së kësaj qeverie në mënyrë që të kemi një stabilitet të paktën për një vit a më shumë. Ndërkombëtarët këtë qeveri e shohin si teknokratike, prandaj u konvenon. Pra, meqenëse Kosova ka mbetur në gjysmë të disa proceseve, jo vetëm të liberalizimit të vizave, por edhe të proceseve të tjera siç është dialogu me Serbinë, atëherë ata do të donin që ta vazhdojnë punën kjo qeveri.

Rudari ia dorëzon Bulliçit detyrën e kryetarit

PODUJEVË, 7 DHJETOR (ER) - Në një ceremoni solemne, të hënën nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ia ka dorëzuar detyrën kryetarit të ri Shpejtim Bulliqi, i cili mandatin e fitoi në procesin e jashtëzakonshëm zgjedhor të zhvilluar më 29 nëntor të këtij viti.

Me rastin e pranimit-dorëzimit të detyrës, ku ishte i pranishëm edhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Podujevës, Fatmir Gashi, nënkryetari Rudari e uroi kryetarin Bulliqi për marrjen e përgjegjësive të reja në udhëheqjen e Komunës së Podujevës dhe i uroi suksese për përmbushjen e obligimeve dhe zotimeve të dhëna para qytetarëve llapjanë.

Kryetari Bulliqi e falënderoi nënkryetarin Rudari për punën dhe angazhimin e tij, sidomos gjatë kohës sa ishte ushtrues i kompetencave të kryetarit të komunës.

Po ashtu, kryetari Bulliqi u

shpreh i gatshëm për bashkëpunim për çështje të rëndësishme për qytetarët llapjanë, duke siguruar angazhim të plotë për përfaqësimin e drejtë të interesave të të gjithë qytetarëve të Podujevës.

Pas betimit solemn, Bulliqi në fjalimin e tij para këshilltarëve komunalë ka thënë se sot po merr një përgjegjësi të lartë, e cila iu besua nga qytetarët e Podujevës, për t'i shërbyer një komuniteti e një rrethine të vendit që assesi nuk është e parametrave të rëndomtë. “Jam jashtëzakonisht i nderuar dhe po aq përgjegjës që në një proces thellësisht demokratik, me bindje të lirë e me vullnet të qartë, llapjanët më kanë deleguar detyrën e drejtimit të ekzekutivit të komunës sonë”, ka thënë kryetari Bulliqi.

Ai ka shtuar se me bashkëpunëtorë e me profesionistë të dëshmuar të Llapit do ta drejtojnë Komunën e



Podujevës. “Një komunë e një komunitet që ka nxjerrë emra të mëdhenj në të gjitha proceset e jetës shoqërore politike, kombëtare, kulturore,

shkencore, artistike e sportive. Një komunë e një komuniteti që, ashtu siç e ka dashur puna dhe detyra e atdheut tonë, i është përgjigjur siç është më së miri.

Pra një region me një traditë e identitet të fuqishëm kombëtar e kolektiv të dëshmuar në çdo rrethanë”, ka thënë kryetari i ri i Podujevës, Shpejtim Bulliqi.

Përveç LV-së, partive të tjera 'nuk iu konvenojnë zgjedhjet'

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Për çështjen e zgjedhjes së presidentit të ri të Kosovës partitë politike parlamentare, në veçanti ato të koalicionit qeverisës, duhet të gjejnë një zgjidhje me marrëveshje politike ose, në të kundërtën, vendi do të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, thonë njohësit e zhvillimeve politike, Donika Emini dhe Artan Muhaxhiri. Sipas tyre, marrë parasysh zhvillimet e muajve të fundit në spektrin politik dhe institucional të Kosovës, shumica e partive politike parlamentare, përveç Lëvizjes Vetëvendosje, do të tentojnë të gjejnë një zgjidhje politike në mënyrë që t'i shmangin zgjedhjet e parakohshme.

Më 5 nëntor Hashim Thaçi dha dorëheqje nga posti i presidentit të Kosovës, pasi Dhomat e Specializuara në Hagë konfirmuan aktakuzën ndaj tij për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Po të njëjtën ditë, bazuar në kompetencat që ia jep Kushtetuta, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, mori postin e ushtrueses së detyrës së presidentit.

Sipas Kushtetutës, Osmani mund të qëndrojë në këtë post për gjashtë muaj deri kur duhet të zgjidhet një president i ri.

Deri më tash Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), që është pjesë e koalicionit qeverisës, ka propozuar që për president të ardhshëm të vendit të jetë lideri i saj, Ramush Haradinaj.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka theksuar se në rast se partitë e tjera parlamentare i kërkojnë votat e saj për zgjedhjen e presidentit, atëherë PDK-ja do t'u ofrojë atyre të propozuarin e vet. Rreth dy javë më parë Isa Mustafa, lider i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), e cila udhëheq koalicionin qeverisës të vendit, ka deklaruar se në fillim të dhjetorit apo në ditët në vijim pritet të organizojë një takim me subjektet e tjera politike për të diskutuar për çështjen e presidentit. Ai ka theksuar se "është më mirë që çështja të zgjidhet tani" sesa të shkohet në zgjedhje të parakohshme.

Donika Emini, drejtoreshë

ekzekutive e Platformës Civiko, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se çështja e zgjedhjes së presidentit në Kosovë gjithmonë ka qenë mjaft e ndjeshme dhe është paraprirë ose pasuar me kriza politike. Sipas saj, aktualisht çështja e zgjedhjes së presidentit të ri të vendit duket të jetë edhe më komplekse për shkak të brishtësisë së qeverisë aktuale dhe rivalitetit të tri partive politike, LDK-së, AAK-së dhe PDK-së. Por, siç thotë Emini, tashmë janë dhënë sinjale që japin për të kuptuar mundësinë që LDK-ja ka hequr dorë nga pretendimi për pozitën e presidentit për shkak se aktualisht mban pozitën e kryeministrit dhe i nevojitet një mbështetje nga një parti më e madhe, në këtë rast PDK-ja, për ta mbajtur qeverinë gjallë.

Por, sipas saj, deri më tash PDK-ja nuk ka ofruar asnjë emër për pozitën e presidentit. "Duket qartë se edhe brenda partisë (PDK-së) nuk ka kohezion, nuk ka kompromis, në raport me kandidatin e PDK-së për president. Por, fakti që u votua Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike dhe pati përafrim me LDK-në, jep indikacione që ata mund ta mbështesin, por normalisht vetëm në rast se presidenten e merr PDK-ja. Në anën tjetër është Haradinaj që është vetëshpallur kandidat (për president). Është e drejtë e tij, si parti politike, mirëpo kjo vetëm sa i shkakton probleme të brendshme, por që mendoj se ky problem mund të zgjidhet për shkak se as AAK-së dhe asnjë prej këtyre partive, të cilat për momentin janë grupuar kundër Lëvizjes Vetëvendosje, nuk u konvenojnë zgjedhjet e reja", tha Emini.

Analisti Artan Muhaxhiri, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", konsideron se çështja e zgjedhjes së presidentit do të jetë pjesë e një pakoje të madhe të marrëveshjeve politike, në një kontekst të koalicioneve potenciale, sepse fuqitë e partive politike, aktualisht, janë në nivelin që asnjëra nuk mund të pretendojë dominimin. Sipas tij, do të duhet të ketë marrëveshje dhe kompromise nga palët, në mënyrë që të arrihet deri te një zgjidhje. Siç thotë Muhaxhiri, deri



më tash LDK-ja është treguar konstruktive, duke u bërë thirrje partive politike që të diskutojnë për çështjen e zgjedhjes së presidentit. "Pretendimet e Ramush Haradinajt për ta fituar postin e presidentit duken jorealiste, sepse nuk kanë një bazë të fuqishme në spektrin politik dhe posaçërisht përbrenda Kuvendit të Kosovës. Ndërsa sa i përket PDK-së, ajo është ende e destabilizuar për shkak të dërgimit të (ish-liderit të saj, Kadri) Veselit në Hagë. Kështu që nuk mendoj se ata kanë një lloj uniteti të atij niveli, që aktualisht të vendosin për emrin e pretenditit për postin e presidentit", theksoi Muhaxhiri. Zyrarët e Partisë Demokratike të Kosovës tashmë kanë paralajmëruar se deputetët e kësaj partie nuk do ta votojnë asnjë kandidat për president nga radhët e partive të koalicionit qeverisës.

Avni Bytyqi, zëdhënës i PDK-së, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se partia e tij e sheh çështjen e zgjedhjes së presidentit si një proces të tërësishëm. "E kemi bërë të qartë disa herë që është e pakuptimtë që si parti opozitare të votojmë për një kandidat që vjen nga koalicioni qeverisës. Nëse partitë që janë shumicë parlamentare kërkojnë votën tonë, atëherë propozimi duhet të dalë nga PDK-ja. PDK-ja ka shumë emra, të cilët do të ishin kandidatë të duhur për të qenë president ose presidente e vendit. Megjithatë, për shkak se nuk ka ndonjë marrëveshje me partitë e tjera parlamentare, ne nuk kemi arritur në fazën ku i nominojmë ose i propozojmë emrat e caktuar nga organet e partisë", theksoi Bytyqi.

Në anën tjetër, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, më 3 dhjetor, gjatë një takimi me gazetarë, ka shprehur besimin që së shpejti do të organizohet

tryeza e partive politike, për ta parë disponimin e tyre për të diskutuar për gjetjen e një zgjidhjeje për presidentin e vendit. "Tash secila prej partive politike ka qëndrime të caktuara. Nuk jemi ulur në tryezë të partive politike parlamentare për të parë së pari se a ka vullnet që të zgjedhet një president dhe nëse ka vullnet, cilat janë propozimet e partive politike. E dimë propozimin e AAK-së. Tash duhet edhe të PDK-së. Besoj se në ditët e ardhshme organizohet kjo tryezë dhe të shohim se si mund të shkojmë më tutje", ka thënë Hoti. Ai ka shtuar se vetëm në tryezë mund të gjenden zgjidhjet lidhur me çështjen e presidentit apo shkuarjes në zgjedhje.

Dilemat e partive politike

Por, cila nga këto të dyja, zgjedhja e presidentit apo zgjedhja e parakohshme parlamentare, kanë gjasa më reale që të zgjedhet nga partitë parlamentare? Analistja Donika Emini shpreh mendimin që për një demokraci më të shëndoshë, në këtë rast, zgjedhjet dhe legjitimitimi i sërishëm do të ishin zgjidhja më e mirë. "Kjo është për shkak se po flasim për zgjedhjen e presidentit, për proceset e tjera të brendshme dhe të jashtme nëpër të cilat po kalon Kosova, si dhe zgjerimi i koalicionit për të dytën herë, do të thotë, ndryshimi i qeverisë pa zgjedhje, vetëm sa është goditje e rëndë për demokracinë. Mirëpo, duke i marrë parasysh rrethanat në Kosovë, fatkeqësisht, më shumë gjasa ka që të ketë përafrim nga këto parti politike, që të bëhen bashkë për t'i evituar zgjedhjet, sepse ato nuk u konvenojnë asnjëherë prej tyre", theksoi Emini.

Edhe analisti Artan Muhaxhiri vlerëson që shumicës së partive politike parlamentare nuk iu konvenojnë zgjedhjet e parakohshme për shkak se gjenden në një situatë tejet të komplikuar dhe nuk kanë asnjë garanci se mund të kenë sukses në zgjedhje. "Kështu që, unë mendoj se ato do të bëjnë ç'mos

që të kërkojnë një zgjidhje jashtë procesit zgjedhor. Mirëpo, nëse kokëfortësitë politike dhe interesat e ngushta dominojnë, atëherë me siguri se do të duhej të shkojmë në zgjedhje dhe të qartësohen pushtetet politike të secilës parti, si dhe më pas të fillohet një proces i ri. Mirëpo, një qasje e tillë ka shumë pikëpyetje, sepse çdo gjë do të varet prej rezultatit zgjedhor, për të cilin nuk mund të garantojë asnjë parti. Posaçërisht PDK-ja dhe LDK-ja kanë shumë dilema dhe pikëpyetje", theksoi Muhaxhiri.

Sipas Kushtetutës, zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të kuvendit. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet president i Republikës së Kosovës.

Nëse në votimin e tretë asnjëri kandidat nuk zgjidhet president i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

Abrashi merr vendim: S'ka më reklama në autostrada, rrugë nacionale dhe rajonale

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka marrë vendim për heqjen e të gjitha panove reklamuese të bizneseve të vendosura në autoudhët, rrugët nacionale dhe rajonale të Republikës së Kosovës.

Po me këtë vendim revokohen të gjitha pëlqimet që janë lëshuar më herët nga Ministria e Infrastrukturës. "Revokohen të gjitha pëlqimet e lëshuara nga Ministria e Infrastrukturës për vendosjen e panove reklamuese në mbikalime, ura dhe tunele në

autoudhët dhe rrugët nacionale dhe rajonale të Republikës së Kosovës, të cilat janë në kundërshtim me paragrafin 1.1 dhe 1.6 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2017 për vendosjen e panove reklamuese", thuhet në vendim.



Deputetja Hajdari viziton Prekazin: Heronjtë si Adem Jashari nuk i kanë munguar kombit shqiptar

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

SKENDERAJ, 7 DHJETOR - Deputetja e Shqipërisë, Rudina Hajdari, ka qëndruar të hënën në Kosovë. Ajo ka vizituar varrin e kryekomandantit të UÇK-së, Adem Jashari. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ajo ka theksuar se nuk mund ta kuptojmë lirinë pa nderuar sakrificat e bëra për të. Hajdari thotë se detyrë e popullit është të nderojmë veprën e tyre jo vetëm duke i kujtuar, por edhe duke punuar fort për ditë që Shqipëria dhe Kosova të jenë bashkë në rrugëtimin drejt Evropës, drejt mirëqenies, drejt ndërtimit të shtetit ligjor, drejt luftës pa kompromis kundër korrupsionit. "Nuk mund ta kuptojmë lirinë pa nderuar sakrificat e bëra për të. E nisa vizitën time në Kosovë duke nderuar sakrificën sublime të familjes Jashari, të kryekomandantit të UÇK-së, Adem Jasharit, të cilët dhanë

jetën në përpjekjen e tyre për t'i dhënë lirinë e pavarësinë Kosovës. Heronjtë si Adem Jashari nuk i kanë munguar kombit shqiptar në vite e kurrë nuk do t'i mungojnë, por detyra jonë është që ta nderojmë veprën e tyre jo vetëm duke i kujtuar, por edhe duke punuar fort për ditë që Shqipëria dhe Kosova të jenë bashkë në rrugëtimin drejt Evropës, drejt mirëqenies, drejt ndërtimit të shtetit ligjor, drejt luftës pa kompromis kundër korrupsionit. Nderim heronjve të lirisë!", ka shkruar Hajdari.

Deputetja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Rudina Hajdari, të hënën ka takuar kryetaren e grupit të grave deputete, Vlora Limani-Hajnuni, deputetet Besa Ismaili dhe Teuta Haxhiu. Kryetarja e GGD-së, Limani-Hajnuni, duke i uruar mirëseardhje deputetes nga Shqipëria, vlerësoi bashkëpunimin e deritashëm ndërmjet grave deputete të Kuvendit të Republikës së



Kosovës dhe atyre nga Shqipëria. Ajo ka thënë se edhe në të ardhmen pret një bashkëpunim më të theksuar nga grupet e grave deputete të dyjave shteteve. Në anën tjetër deputetja e

Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Rudina Hajdari, duke falënderuar për mikpritjen, tha se ndihet e nderuar që gjendet për vizitë në Kosovë dhe në kuvendin e saj. Ajo ka theksuar se

bashkëpunimi në mes të grave deputete të Shqipërisë dhe të Kosovës do të vazhdojë edhe më tej, me theks të veçantë në avancimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe forcimit të rolit të saj në vendimmarrje.

Ministri Selimi diskuton për Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, së bashku me zëvendësministrin, njëherësh Koordinatorin Nacional Kundër Dhunës në Familje, Florian Dushi, dhe aktorë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë të sistemit të drejtësisë, sot kanë diskutuar për Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Ky diskutim është bërë në një takim të realizuar nga Ministria e Drejtësisë në kuadër të fushatës së "16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore". Me këtë rast, ministri Selimi tha



se Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

dhe Planin e Veprimit 2010-2020, i cili trajton shërbimet për viktimat dhe ndjekjen penale të kryesve të krimit. "Viktimitave iu duhet mbështetja për t'i pasur burimet dhe ndihmën për t'u

larguar nga marrëdhëniet e dhunshme. Kurse kryesit e krimit duhet ta dinë se sjellja e tyre ka pasoja. Me zbatimin e planit të veprimit do të ndërmerren hapa rrënjësorë për të siguruar mbrojtje dhe drejtësi për viktimat", tha ministri Selimi.

Ministri Selimi ka përmendur të arriturat e Ministrisë së Drejtësisë në këtë fushë, siç janë: ndryshimet ligjore ku është përfshirë dhuna në familje si vepër e veçantë në Kodin Penal të Kosovës, krijimi i bazës së integruar të të dhënave për evidentimin e rasteve të

dhunës në familje, si dhe nënshkrimi i Memorandum Bashkëpunimit me strehimoret e viktimave të dhunës në familje, për qasje dhe lehtësim në punësim të personave të strehuar në strehimoret e dhunës në familje dhe viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Gjatë këtij takimi ministri Selimi tha se Kosova gjatë hartimit të politikave për mbrojtjen nga dhuna në familje është kujdesur që të harmonizohet me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjilani do ta ndihmojë Bashkinë e Lezhës për sanimin e pasojave nga tërmeti

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

GJILAN, 7 DHJETOR - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, bashkë me komitetin për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, ka pritur të hënën në takim pune ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. "Faleminderit ambasadorit Minxhozi që, përveç mbështetjes dhe interesimit të vazhdueshëm, Gjilani po i sjell edhe miqësi dhe bashkëpunim me të gjitha

potencialet që i ka. Sot do ta vizitojmë ekonominë gjilanase, prodhimin dhe biznesin privat. Për sanimin e pasojave të tërmetit i konfirmova se Komuna e Gjilanit ka zgjedhur ta mbështesë Bashkinë e Lezhës", ka bërë me dije Haziri pas takimit.

Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe për projektin e përbashkët humanitar me rotarianët e Gjilanit për rikonstruktimin e objekteve të

dëmtuara nga tërmeti në Lezhë. "Faleminderit nga zemra për këtë pritje shumë të ngrohtë dhe vëllazërore. Unë dëgjova me kujdes për punën që ka bërë komiteti, një organizim i madh dhe shembullor. Më bëri përshtypje që Gjilani ka qenë qendër për menaxhimin e pandemisë edhe për qytetarët e Luginës. Kjo tregon se sa të bashkuar jemi ne edhe në raste të emergjencave. Kjo duhet të merret shembull edhe nga komunat e tjera", ka thënë ambasadori Minxhozi.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Projektligji i Punës së shpejti

Në mbledhjen e së hënës të Qeverisë së Kosovës është marrë vendim që Projektligji i Punës dhe Projektligji për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror të fuzionohen në një ligj të vetëm i cili do të miratohet deri më 15 dhjetor 2020. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka bërë me dije se Projektligji i punës dhe i Pushimit të Lehonisë së shpejti do të dërgohen për miratim në Kuvendin e Kosovës

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 7 DHJETOR - E drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, Qeveria e Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt, e 48-ta me radhë, në të cilën janë shqyrtuar dhe miratuar dokumente dhe politika të ndryshme të fushave të saj të përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore. Me vendimin e parë të miratuar në këtë mbledhje, është bërë ndryshimi dhe plotësimi i programit legjislativ të viti 2020.

Sipas vendimit të aprovuar, Projektligji i Punës dhe Projektligji për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror të fuzionohen në një ligj të vetëm i cili do të miratohet deri më 15 dhjetor 2020. Ndërsa shtohet në programin legjislativ për vitin 2020 miratimi i Projektligjit për Ratifikimin dhe Amendamentimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka bërë me dije se Projektligji i Punës dhe ai i Pushimit të Lehonisë së shpejti do të dërgohen për miratim në Kuvendin e

Kosovës. “Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar iniciativën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që Projektligji i Punës dhe Pushimit të Lehonisë dhe Prindëror të Miratohen nga qeveria deri më 15 dhjetor 2020. Ky është një hap i rëndësishëm drejt realizimit të reformave që kam filluar të ndërtoj si ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale në funksion të përmirësimit të infrastrukturës ligjore, për më shumë të drejta për të gjithë punëtorët në vendin tonë e në harmoni me standardet evropiane të marrëdhënies së punës”, ka thënë Reçica pas mbledhjes së qeverisë.

Qeveria në këtë mbledhje ka shqyrtuar dhe miratuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë lidhur me amendamentin nr. 1 të marrëveshjes kornizë për bashkëpunim financiar.

Në këtë mbledhje ka marrë miratimin edhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore. Shitja apo privatizimi i banesave në pronësi shoqërore dhe publike ka filluar në vitin 1992 në Kosovë. Me ndërrimin e sistemit kushtetues dhe

ndryshimin e rrethanave politike, ekonomike dhe sociale në Kosovë, çështja është rregulluar me Ligjin për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore miratuar në vitin 2011, sipas të cilit, qytetarëve u është dhënë mundësia që fillimisht brenda afatit dyvjeçar, më pas edhe me vazhdimin trevjeçar, me qëllim që të gjithë ata që nuk kanë mundur të blejnë banesat, apo u është pamundësuar blerja në të cilën në mënyrë ligjore e kanë fituar të drejtën banesore t’u

mundësohet blerja e banesës me kushte të përafërta siç është bërë gjatë viteve 1992-’99. Meqenëse afatet e përshkruara në këtë ligj tashmë kanë skaduar dhe gjendja e shitjes së këtyre banesave është e papërfunduar, ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji e zgjasin aftin për shitjen e këtyre banesave edhe për tri vjet, përkatësisht deri në vitin 2023.

Nga kabineti qeveritar është miratuar edhe propozimi i Komisionit përzgjedhës për

rekomandim të kandidatëve për anëtarë të Bordit të Organi Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP). Gjithashtu, është aprovuar edhe propozimi i Komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e zëvendës drejtorit të sekretarisë ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Qeveria e Kosovës ka aprovuar planin kombëtar të veprimit për efikasitet të energjisë për periudhën 2019-2021. Vendimi obligon Ministrinë e Ekonomisë dhe

KRU “Prishtina” konsumatorët borxhlinj i dërgon te përmbaruesit privatë

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” ka kërkuar nga konsumatorët që ta përbushin obligimin ndaj pagesës së faturave të rregullta mujore për shpenzimin e ujit. KRU “Prishtina” ka njoftuar se do të fillojë

përfundimisht procedimi i konsumatorëve borxhlinj në procedurë përmbarimore te përmbaruesit privatë. “Inicimi i kësaj procedure përmes përmbaruesve privatë krijon shpenzime shtesë për ju dhe do ta vë shtirëson te përbushjen e obligimit

tuaj duke paguar taksën shtesë. Janë përgatitur 250 lëndë që të dërgohen në këtë javë te përmbaruesit privat (kryesisht lëndë me borxhe të larta), ndërsa edhe 250 lëndë të tjera javën tjetër”, është bërë me dije në njoftimin e KRU “Prishtina”.



dërgohet në Kuvend



Departamenti për Drejtësi Tranzicionale në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë do ta zëvendësojë Fetnete Ramosajn nga Instituti për Krime të Luftës.

Është aprovuar edhe propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për zgjatjen e mandatit të grupit të ekspertëve të pavarur për dizajnim të parimeve, skenarëve dhe elementeve të reformës së vetingut në sistemin e drejtësisë. Afati për paraqitjen e raportit të këtij grupi shtyhet deri më 15 dhjetor 2020.

Miratimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe propozimi tjetër i Ministrisë së Drejtësisë për formimin e grupit punues për përgatitjen

e analizës për themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Ky grup do t'i analizojë mundësitë e themelimit të këtij instituti si dhe do t'i identifikojë praktikatat më të mira krahasuese me elementet dhe specifikat që mund të përfshihen në rastin e Kosovës.

Në këtë mbledhje të qeverisë është miratuar edhe Projektligji për Lotarinë e Kosovës i cili rithemelon Lotarinë e Republikës së Kosovës si suksesor juridik i Lotarisë së Kosovës sh. a. e cila është mbyllur me Ligjin për ndalimin e lojërave të fatit. Me këtë Projektligj synohet rregullimi,

organizimi dhe funksionimi i Lotarisë së Republikës së Kosovës, llojet e lojërave, kushtet dhe mënyra e organizimit, rregullat dhe mbikëqyrja e tyre si dhe mënyra e shpërndarjes së të ardhurave nga lojërat e fatit të lotarisë.

Qeveria ka aprovuar edhe kërkesat e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së, Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe Lidhjes së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Republikës së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në vlerën prej 203,000.00 eurosh nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike.

BSPK-ja: Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike është diskriminues për disa sektorë

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) konsideron se Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike, respektivisht pakoja e Trustit Pensional është diskriminuese për disa sektorë. Përmes një reagimi për media BSPK-ja ka vlerësuar se shpreson që të mos ketë diskriminime të tilla në pakot e tjera. "BSPK konsideron se, sipas Konventës (ILO - C100) së Organizatës Botërore të Punës, e miratuar në Pragë në vitin 1951, e cila e rregullon barazinë në paga, Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike, respektivisht pakoja e Trustit Pensional, është mjaft diskriminuese në disa sektorë. Edhe pse është një infuzion i vonuar për ekonominë tonë të brishtë, shpresojmë se në



pakot e ardhshme mos të ketë diskriminime të tilla në mënyrë që të përfitojnë qyte-

tarët në mënyrë të barabartë", është thënë në reagimin e BSPK-së.

Ambientit si dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e masave që dalin nga ky dokument. Ky plan ka për qëllim arritjen e objektivave të politikës shtetërore në fushën e efikasitetit të energjisë, duke përfshirë skemën obliguese dhe masat alternative të efikasitetit të energjisë, masat e politikave për efikasitet të energjisë, kursimet e energjisë të arritura ose të planifikuara për t'u arritur në nivelin e furnizimit, transmissioinit, shpërndarjes

dhe konsumit final të energjisë, në mënyrë që të përmbushen objektivat kombëtare të efikasitetit të energjisë. Ky dokument gjithashtu përfshin një vlerësim të zbatimit të planit paraprak 2016-2018. Qeveria ka ndryshuar dhe plotësuar vendimin për themelimin e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare në Kosovë. Sipas këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve, Ilir Gutaj, nga

Gastronomët kërkojnë që të mos kufizohet puna gjatë festave

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Shoqata e Gastronomëve e Kosovës ka reaguar pas miratimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike nga pandemia Covid-19. Gastronomët në këtë reagim kërkojnë nga Qeveria e Kosovës që të mos ketë kufizim të punës gjatë festave të fundvitit. "Lusim

Qeverinë e Kosovës të na lejojë të punojmë. Jemi pranë festave dhe qytetarëve të Kosovës, po ashtu edhe diasporës duam t'u qëndrojmë më afër në kohë më të gjatë pune dhe sadopak ta përmbyllim së bashku një vit të brishtë, duke u mundësuar kështu edhe bizneseve të

mbijetojnë. Është mundësia jonë e fundit që sadopak të mbesim në këmbë këtë vit. Me tri lule nuk çel pranvera! Nëse qëndron ideja të lirohen masat vetëm për tri net të Vitit të Ri, atëherë për ne si gastronom mos e bëni fare", është thënë në reagimin e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës.



Shënohet Java e Rinisë në Malishevë

MALISHEVË, 7 DHJETOR (ER) - Duke respektuar masat anti-Covid, organizuar nga Qendra Rinore e Malishevës, me drejtor Amrush Helshanin, u mbajt debati me temën "Roli i rinisë në vendimmarrje dhe aktivitetet e rinisë në kohë pandemie".

"Në kuadër të Javës së Rinisë në Malishevë që po organizohet, jo në kohën e duhur, arsye e vetme është pandemia me Covid-19, por ne do ta sfidojmë edhe këtë

virus e me aktivitetet e parapara do të jemi aktivë në javën e rinisë me moton: 'Së bashku ndërtojmë të ardhmen', si me debate, poezi, ese, sport dhe në ekspozitë me punimet e artistëve, po sot edhe zyrtarisht licencohet Qendër Rinore në Malishevë", ka thënë Helshani.

Në këtë debat ka marrë pjesë edhe drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Mazreku, së bashku me zyrtarin për rini, Mehdi

Krasniqi. "Edhe në këto kushte e rrethana të vështira pandemike ne si institucione dhe qeveri lokale e Komunës së Malishevës po bëjmë përpjekje që t'u ndihmojmë për realizimin e kërkesave dhe projekteve tuaja, prandaj sot edhe zyrtarisht Qendra Rinore bëhet me licencë trevjeçare. Kërkoj nga ju që të jeni aktivë në të gjithë sektorët, pasi edhe objektet kulturore e sportive janë në shfrytëzimin tuaj", ka thënë Mazreku.



Brenda këtij muaji fillon rregullimi i tri rrethrotullimeve në Prishtinë



PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, në një shkrim publikuar në "Facebook" ka njoftuar se është duke u rregulluar

rrethrotullimi në lagjen "Arbëria" me ndarje fizike. Ai ka njoftuar edhe për rregullimin e rrethrotullimit që lidhë rrugën "B" dhe "C" si dhe lagjen "Kalabria". "Ndarjet e tilla fizike

në tre rrethrotullime të tjera më herët kanë ndihmuar me rregullim të qarkullimit të trafikut dhe rritje të sigurisë për të gjithë pjesëtarët e trafikut", ka shkruar Ahmeti.

Mbi 43 mijë libra për bibliotekat e shkollave të Lipjanit

LIPJAN, 7 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka bërë me dije se ka filluar furnizimi me libra të ndryshëm për bibliotekat e shkollave në territorin e kësaj komune me mbi 517 tituj të ndryshëm. Ai ka treguar se shpërndarja e këtyre librave do të vazhdojë

edhe në ditët e ardhshme. "43 288 libra për bibliotekat e shkollave të Komunës së Lipjanit", ka thënë Ahmeti. Ndërkaq drejtoresha e Arsimit në Lipjan, Elmaze Behluli, është shprehur se këto libra do t'i pasurojnë shumë bibliotekat e shkollave.



Komuna e Mitrovicës nënshkruan marrëveshje bashkëfinancimi me IOM-in

MITROVICË, 7 DHJETOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, së bashku me drejtorin për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, drejtorin e ShFMU "Fazli Greiçevci", Arben Fejza, si dhe zyrtarin nga zyra për komunitete dhe kthim, Enis Kacapor, kanë pritur në takim përfaqësuesen nga

organizata IOM, Igballe Dobra-Ymeri. Qëllimi i këtij takimi ishte nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëfinancim në mes të Komunës së Mitrovicës dhe IOM-it, marrëveshje kjo që ka të bëjë me pajisje komplet me kabinetin shkencor për shkollën e lartcekur e që kap vlerën totale prej 9 591.00 eurosh.

Komuna e Mitrovicës do ta mbështesë implementimin e projektit për kabinetin e lëndëve shkencore në shkollën "Fazli Greiçevci" në Mitrovicë, ku në këtë shkollë vijojnë mësimin, përveç nxënësve shqiptarë, edhe ata të komunitetit ashkali. Implementimi i këtij projekti do të krijojë kushte të veçanta edukative dhe arsimore.



129 biznese individuale në Kamenicë përfitojnë subvencione

KAMENICË, 7 DHJETOR (ER) - Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporës në Kamenicë, pas thirrjes publike për aplikim për subvencione, ka shpallur

listën e bizneseve individuale përfituese. Sipas komisionit të formuar për vlerësimin e aplikacioneve, 129 biznese individuale kanë përfituar në

bazë të plotësimit të kriterëve të vendosura nga komisioni. Shuma e cila është ndarë për subvencionimin e bizneseve individuale është 64 500 euro.



Muaji i kaluar ka qenë “nëntori më i nxehtë i regjistruar ndonjëherë”

Bruksel, 7 dhjetor - Muaji i kaluar ka qenë nëntori më i nxehtë, i regjistruar ndonjëherë në planetin Tokë dhe Evropa është përballur me temperatura rekorde në këtë periudhë. Shërbimi i Ndryshimit të Klimës Copernicus (C3S) ka analizuar temperaturën e sipërfaqes dhe të ajrit dhe ka gjetur se nëntori i vitit 2020 ka qenë për 0.77 gradë celsius më i nxehtë se mesatarja 30-vjeçare, nga viti 1981 deri më 2010. Temperatura mesatare shtator-nëntor për Evropën, ka qenë më

e larta në histori dhe 1.9 gradë celsius mbi periudhën e referimit. Shërbimi i Ndryshimit të Klimës Copernicus, që është pjesë e shërbimit satelitor të Bashkimit Evropian, ka thënë se 2020 ka qenë në linjë me vitin 2016, që është viti më i nxehtë në histori. Javën e kaluar, Organizata Botërore për Meteorologji, ka thënë se pret që viti 2020 të jetë një nga tre më të nxehtët - mbra-pa viteve 2016 dhe 2019. Drejtori i Shërbimit të Ndryshimit të Klimës

Copernicus, Carlo Buontempo, ka thënë se incizimet “janë në përputhje me trendet afatgjata të ngrohjes globale” andaj u ka bërë thirrje ligjvënësve që të “shqyrtojnë më seriozisht se kurrë qasjen ndaj përkushtimeve ndërkombëtare”, të përcaktuara në Marrëveshjen e Parisit për Klimën, të nënshkruar më 2015. Sipas kësaj marrëveshjeje, shtetet nënshkruese janë përkushtuar për qëllim afatgjatë të kufizimit të temperaturës mesatare në 1.5 gradë celsius.



ShBA-ja dhe Kina dominuan tregun e armëve në 2019-n



NJU JORK, 7 DHJETOR - Kompanitë amerikane dhe kineze dominuan tregun global të armëve në vitin 2019. Një raport i lëshuar të hënën nga Instituti Ndërkombëtar për Kërkim të Paqes, me seli në Stokholm, tregon se këto kompani kanë përbërë mbi 75 për qind të shitjeve vitin e kaluar. Nga 25 kompanitë më të mëdha të armëve në botë, 12 kanë qenë amerikane dhe kanë përbërë 61 për qind të shitjeve të armëve dhe shërbimeve ushtarake, ndërsa shitjet e kompanive kineze kanë qenë 15.7 për qind,

thuhet në raport. Shitjet totale nga 25 kompanitë e para janë rritur për 8.5 për qind, përkatësisht në 361 miliardë dollarë, thekson po ashtu raporti. Lista vazhdon të udhëhiqet nga kompania amerikane e hapësirës ajrore Lockheed Martin. Shtetet e Bashkuara kanë dominuar tregun ndërkombëtar të armëve me dekada, por shitjet e kompanive kineze janë rritur për gati 5 për qind në vitin 2019, thuhet në raport. Raporti i Institutit

Ndërkombëtar për Kërkimin e Paqes po ashtu tregon se, për herë të parë, një kompani nga Lindja e Mesme është futur në mesin e 25 kompanive më të mëdha të armëve në botë. Bëhet fjalë për kompaninë EDGE nga Emiratet e Bashkuara Arabe, e cila është formuar nga konsolidimi i rreth 25 subjekteve të mbrojtjes në vitin 2019. I krijuar nga Parlamenti i Suedisë më 1966, Instituti Ndërkombëtar për Kërkim të Paqes gjurmon shpenzimet ushtarake dhe transferimet e armëve.

Presidenca gjermane e BE-së, e frustruar për dështimet në procesin e zgjerimit

BRUKSEL, 7 DHJETOR - Procesi i zgjerimit të Bashkimit Evropian nuk pritet të jetë temë e samitit të BE-së që do të zhvillohet të enjten dhe të premten në Bruksel, ndërsa edhe në takimin e së martës të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme do të jetë vetëm si temë eventuale jashtë rendit të ditës, apo si “çështjet e tjera”. Një diplomat i lartë i BE-së tha se arsytet për këtë janë agjenda e ngjeshur dhe dështimi që të ketë përparim në miratimin e kornizave negociuese, për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Ky diplomat i lartë evropian tha

se “Gjermania, si kryesuese e radhës e BE-së, është e frustruar, për shkak të këtyre dështimeve”, dhe fajin për këtë ia la Bullgarisë, e cila vazhdon të bllokojë miratimin e vendimit për nisjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut. “Si pasojë e bllokadës së vendimit për Maqedoninë e Veriut, që Bullgaria e ka bërë për shkak të çështjeve bilaterale historike, që nuk kanë vend në procesin e zgjerimit, nuk kemi mundur të vendosim as për Shqipërinë, sepse disa shtete kanë insistuar se, nëse nuk ka vendim për Maqedoninë e Veriut, nuk mund të vendosim as për



Shqipërinë”, tha diplomati i lartë evropian. Bullgaria ka

insistuar që obligimet e Maqedonisë së Veriut për të

respektuar disa çështje historike, që Sofja i sheh si fakte, të jenë pjesë e kornizës negociuese të BE-së. Diplomatët evropianë pohojnë se Gjermania ka bërë përpjekje që të arrihet një zgjidhje midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut, por ato përpjekje kanë dështuar. Një diplomat evropian tha se nuk sheh ndonjë mundësi për ndonjë kthesë pozitive në momentin e fundit, pra para përfundimit të presidencës gjermane më 31 dhjetor, kështu që Gjermania do ta përmbyllë presidencën e saj pa asnjë rezultat në zgjerim.

Opozita fiton zgjedhjet në Rumani

BUKURESHT, 7 DHJETOR - Social-Demokratët e opozitës në Rumani shënuan fitore kundrejt Partisë qeverisëse Liberale Kombëtare në zgjedhjet parlamentare të së dielës. Me gati të gjitha votat e numëruara, Social-Demokratët majtistë fituan 29.8 për qind në Dhomën e Deputetëve dhe 30.2 për qind në Senat. Partia Liberale Kombëtare, e

cila është pro-evropiane, fitoi 25.1 për qind në Dhomën e Deputetëve dhe 25.5 për qind në Senat. Megjithatë, ka pak gjasa që Social-Demokratët të marrin udhëheqjen e qeverisë, pasi partia e kryeministrit Ludovic Orban ka më shumë aleatë të mundshëm. Pjesëmarrja në zgjedhje ka qenë rekord e ulët: 33 për

qind. Rumania është një nga vendet më të varfra në Bashkimin Evropian dhe miliona qytetarë të saj janë zhvendosur jashtë vendit viteve të fundit, në kërkim të një jete më të mirë. Liberalët mbështesin integrimin më të afërt në BE, ndërsa Social-Demokratët janë më nacionalistë dhe më populistë.



Ali Ahmeti shkenctari i politikës integruese fitimtare, progresive demokratike të kombit, mbulohet me aureolën Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës!

ALI AHMETI DEKOROHET 'DOCTOR HONORIS' CAUSA I UNIVERSITETIT TË TETOVËS



Ismet SYLEJMANI

Ngjarje Historike,

Më 17 Dhjetor 2020 në Universitetin e Tetovës, Ali Ahmeti, Udhëheqësi i popullit shqiptar, do të mbulohet me aureolën e "Doctor Honoris Causa" të Universitetit të Tetovës! Dekorohet e nderohet me mirënjohje e lavdi shkencore, politikani patriot shkencëtar, politikani atdhetar kombëtar që me fanatizëm, ka luftuar e lufton për çdo pëllëmbë të tokës shqiptare, për çdo të drejtë të çdo pjestari të popullit e kombit të tij shqiptar!

Askujt më mirë e më shumë, se sikur Ali Ahmetit, që është marrë me çdo gjë të popullit të tij, nuk i qëndron dekorata morale nderuese shkencore e politikantit progresiv politik-patriotik, jo vetëm të Universitetit të Tetovës, por të çdo universiteti shqiptar, në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni të Veriut, por edhe të botës euroatlantike progresive demokratike!

Biri i madh Ali Ahmeti, meriton gjithëçka të mirë të popullit, Atdheut e Kombit të Tij, sepse një jetë të tërë, ka qëndruar në nivel e i gatshëm për të kryer çdo detyrë në shërbim të çështjes shqiptare, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës nga Serbia pushtuese!

Ali Ahmeti, veprimtari i shquar politik kombëtar, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, ish i burgosuri politik në Kosovë, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, ilegal i madh politik kombëtar, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, Udhëheqësi shumëvjeçar i LPRK-LPK-së, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, themeluesi i UÇK-së, UÇPMB-së dhe UÇK-së në Maqedoninë e Veriut, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, luftëtar, ushtari e komandanti lavdimadhi i çlirimit të Kosovës dhe Viseve të saja nën ish-jugosllavi, do të dekorohet



Doktor Honoris Causa i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, Anëtar i Shtabit Qendror të UÇK-së në Kosovë, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, Anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇPMB-së, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti Komandant i Përgjithshëm i UÇK-së në

Maqedoninë e Veriut, do të dekorohet Doktor Honoris Causa i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti Perfaqësues Politik i UÇK-së në Maqedoninë e Veriut, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, themelues dhe Kryetar i BDI-së, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, Udhëheqësi me i

madh politik shqiptar i pas vitit 2000, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Gjeneral Ali Ahmeti, nderon çdo institucion e vatër të lartë edukativo-arsimore që e vendosë Atë në rreshtin e parë të nderimit publik shkencor, edukativo-arsimorë!

Populli shqiptar te Udhëheqësi i Tij Ali Ahmeti, sheh njërin nga

figurat më të përsosura e më të përgaditura të liderëve të mëdhenj e karizmatik të fillimit të vitit 2000 e këndej deri në ditët e sotme!

Ali Ahmeti, vazhdues besnik dhe realizator i çelikt i endrrave te Kryeheroit kombëtar Skenderbeut, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, praktikues largpamës i Programit liridashës, luftarak e

çlirimtar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, do të dekorohet Doktor Honoris Causa i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, mbajtës i fuqishëm i flamurit kombëtar shqiptar, i cili pas Skënderbeut, për herë të parë u valëvit nga duart e Plakut të Pavarësisë së Shqipërisë, i urti Ismail Qemali, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, realizatori në masën e madhe të idealeve lirishtetërore e çlirimtare për tokë e Atdhe, popull e Komb të aspiruara nga arkitekt e ideolog të mëdhenj si Hasan

atdhetare, dhe ka kapur dhe mbajtur fuqishëm çdo fije të çështjes së çlirimit të popullit shqiptar nga Serbia pushtuese, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, shqiptari legjendar i gjeneratës se re të madhe historike, që në takimin me presidentin e Shqipërisë Rexhep Meidani, në delegacionin e LPK-UÇK-së, kishte kënduar këngën e famshme ushtarake "...po pyet botë për Shqipërinë, sa të madhe e ka ushtrinë...!"

Ali Ahmeti, meriton dekoratën Gjergj Kastrioti Skenderbeu të

Ali Ahmeti, meriton dekoratën e Ushtrisë së Shtetit Kosovës!

Ali Ahmeti, meriton dekoratën e shtetit të Shqipërisë!

Ali Ahmeti, meriton dekoratën e shtetit të Kosovës!

Ali Ahmeti, meriton tituj të pafund nderimi e respekti nga çdo institucion prestigjioz të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe të gjitha pjesëve të tjera shqiptare dhe në diasporë!

Dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, Ali Ahmeti, shoku e bashkeveprimtari i dhjetra, qindra e mijëra aktivistëve,

shqiptari i madh Ali Ahmeti, i cili deklarohet kudo se Udhëqës të Tij ka pasur Adem Demaçin, Jusuf Gervallën, Kadri Zeken, Rexhep Malajn, Nuhi Berishën, Hydajet Hysenin e Mehmet Hajrizin!

Pas burgosjeve të udhëheqjes së lartë ilegale të ngjarjeve të mëdha të pranverës së kuqe të vitit 1981, Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti, që më 17 Dhjetor 2020, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, zvendësoi me madhësi e profesionalizëm Sekretarin Organizativ, ilegalin e madh Hydajet Hysenin!

Dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, Ali Ahmeti, dirigjenti organizativ fantastik i luftës ilegale patriotike për liri dhe pavarësi të Kosovës nga Serbia pushtuese, bëhet më i famshmi dhe mbulon çdo pore e çdo fushë të veprimit organizativ politik kombëtar në Kosovë dhe Visë!

Dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, Ali Ahmeti, shoku e bashkeveprimtari i Udhëheqësit të madh e të lavdishëm, Komandantit e Gjeneralit legjendarë të UÇK-së, Heroit të Kombit Fehmi Lladrovci!

Dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, Ali Ahmeti, shoku e bashkeveprimtari i Udhëheqësve të mëdhenj të Komitetit Drejtues të LPRK-së të zgjedhur në Divjakë të Berishës, Heronjëve të Kombit Fadil Vata dhe Afrim Zhitia!

Për këto dy figura të mëdha Gjeneral Fehmiun dhe Udhëheqësin e popullit shqiptar Ali Ahmeti, i cili dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, ka shkruar shumë dhe jo vetëm për këta, Kryetari i LPK-së i kohës së luftës finale të UÇK-së, i mirënjohuri, atdhetari i madh dhe politikani patriot, luftëtari e shkrimtari i shquar Bedri Zenel Islami, i cili nderohet me këtë eveniment të madh si njëri prej shokëve dhe bashkpunëtorëve të ngushtë të Ali Ahmetit, i cili më 17 Dhjetor 2020, mbulohejt përgjithmonë me nderimin më të madh të dekorimit spektakular shkencor!

Dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, Ali Ahmeti, integristi i famshëm jo vetëm i popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut, por i të gjithë popullit shqiptar në Ballkan dhe në tërë diasporën shqiptare kudo që ajo jeton nëpër botë!

Dekorimi i Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, i gëzon pafundësisht të gjithë atdhetarët pa përjashtim, të të gjitha gjeneratave dhe të të gjitha moshave!

Dekorimi i Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, nderon gjakun e derdhur për liri, nderon Heronjtë dhe Dëshmorët e Kombit, nderon luftëtarët dhe të plagosurit e lirisë, familjet e të rënëve për liri, invalidët dhe veteranët e të të gjitha Ushtrive Çlirimtare në Kosovë, Luginë të Preshevës dhe në Maqedoninë e

Veriut!

Dekorimi i Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, nderon katërshën(4) e madhe themeluese dhe pagëzuese të UÇK-së, Kryetarin historik të Degës Jashtë Vendit të LPK-së Prof. Fazli Velion, Xhavit Halitin, Emrush Xhemajlin dhe Gafur Elshanin!

Dekorimi i Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, nderon Plakun e madh të Drenicës Kreshnike, Heroin e Kombit Shaban Jashari me Gjeneralet e Komandantët legjendarë të UÇK-së Hamëz e Adem Jashari dhe tërë familjen lavdimadhe Jashari të Prekazit heroik!

Dekorimi i Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, nderon Plakun e madh të Dukagjinit të pamposhtur, Heroin e Kombit Hilmi Haradinaj me Gjeneralet e komandantët emlematik të luftës për liri e çlirim Heronjëve të Kombit Luan e Shkelzen Haradinaj dhe tërë familja e madhe Haradinaj e Gillogjanit heroik!

Dekorimi i Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, nderon luftën heroike dhe titanike të çdo ushtari e ushtaraku, te çdo togu, skuadre, brigade e Zone të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të UÇPMB-së e të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare!

Dekorimi i Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, nderon katërcipërisht të gjitha marrveshjet ndërkombëtare, ngjarjt dhe evenimentet e mëdha me karakter ndërkombëtar si Marrveshja e Ohrit, Marrveshja e Pespës dhe shumë kontribute të mëdha e vendimtare ne stabilitetin e Maqedonisë së Veriut!

Dekorimi i Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, nderon partneritetin e përhershëm të Maqedonisë së Veriut me aleatin e mikun e madh të kombit shqiptar SHBA-në, nderon hyrjen dhe pranimin e Maqedonisë së Veriut në NATO dhe BE!

Dekorimi me "Doctor Honoris Causa" të Universitetit të Tetovës, të Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, është eveniment i madh historik, të cilin memoria kombëtare do ta vendosë në ballin dhe gjoksin e Atdheut, aty ku zënë vendin solemn dekoratat dhe mirënjohjet e mëdha e të lavdishme të të mëdhenjëve truallit të Arbërit!

Dekorimi me "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës, të Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, nderon heroizmin e popullit tonë ndër shekuj!

Urime Abaz Gjuka!

Urime i madhi i të mëdhenjëve!

Urime shoku, vëllau, bashkëveprimtari e miku ynë i madh, Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti!

Prishtinë, më 4 Dhjetor 2020!



Prishtina, e kryeluftëtarë e strateg ushtarak lirishtetërore si Isa Boletini, Luigj Gurakuqi, Idriz Seferi, Bajram Curri, Azem Bejta e shumë të tjerë, do të dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës!

Ali Ahmeti, emblema e atdhetarit të përsosur që me pjesmarrjen dhe ndikimin e Tij, ka shtrirë kudo dorën e Tij të artë organizative dhe mendjen e Tij të shëndoshë

Shqipërisë!

Ali Ahmeti, meriton dekoratën Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kosovës!

Ali Ahmeti, meriton dekoratën Lidhja Shqiptare e Prizrenit!

Ali Ahmeti, meriton dekoratën e Pavarësisë së Shqipërisë!

Ali Ahmeti, meriton dekoratën e Pavarësisë së Kosovës!

Ali Ahmeti, meriton dekoratën e Ushtrisë së Shtetit të Shqipërisë!

veprimtarëve, atdhetarëve, patriotëve, ish të burgosurve politik, politikanëve ilegal atdhetar dhe i një kontigjenti të pafund të erupsionit zingjiror që shpërthente dhe rrjedhëte si llavë vullkani në shërbim të çështjes kombëtare e të përgaditjes së luftës për çlirim të Kosovës nga Serbia pushtuese!

Dekorohet "Doctor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës,




QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kosova në grup me Spanjën, Shqipëria me Anglinë

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll dhe Kombëtarja e Shqipërisë kanë mësuar kundërshtarët për kualifikimet në Botërorin e vitit 2022. "Dardanët" do të luajnë në Grupin B së bashku me Spanjën, Suedinë, Greqinë dhe Gjeorgjinë. Kosova ishte për herë të parë në short për kualifikimet e Botërorit. "Dardanët" kanë garuar edhe në kualifikimet e Botërorit të kaluar, "Rusia 2018", por grupi i ishte përcaktuar me vendim të FIFA-s, pas pranimit në këtë asociacion. Ndërsa Shqipëria do të jetë e pozicionuar në grupet me 6

skuadra me më shumë mundësi kualifikimi, por gjithsesi në grupin e parë kuëzinjtë do të kenë Anglinë, Poloninë, Hungarinë, Armeninë dhe kundërshtari i fundit San Marino. Ndeshjet e para kualifikuese për Botëror luhen më 24 e 25 mars të vitit të ardhshëm. Në mars janë tri termine për ndeshje, kurse ndeshjet tjera luhen në shtator, tetor dhe nëntor të vitit të ardhshëm. Botërori në Katar mbahet prej 21 nëntorit e deri më 18 dhjetor të vitit 2022. Vendi i parë në grup kualifikues siguron biletën për Botëror, ndërsa vendi i dytë siguron fazën e plejofit.



TË GJITHA GRUPET:

Grupi A: Portugalia, Serbia, Irlanda, Luksemburgu, Azerbajxhani
Grupi B: Spanja, Suedia, Greqia, Gjeorgjia, Kosova
Grupi C: Italia, Zvicra, Irlanda e Veriut, Bullgaria, Lituania
Grupi D: Franca, Ukraina, Finlanda, Bosnje Hercegovina, Kazakistani
Grupi E: Belgjika, Uells, Çekia, Bjellorusia, Estonia
Grupi F: Danimarka, Austria, Skocia, Izraeli, Ishujt Faroe
Grupi G: Holanda, Turqia, Norvegjia, Mali i Zi, Letonia
Grupi H: Kroacia, Sllovakia, Rusia, Sllovenia, Qipro
Grupi I: Anglia, Poloni, Hungaria, Shqipëria, Andorra
Grupi J: Gjermania, Rumania, Islanda, Maqedonia e Veriut, Armenia

Peja në kërkim të fitores së gjashtë

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Ndeshja kryesore në xhiron e gjashtë në Prince Caffè Superligë do të zhvillohet ndërmjet Pejës dhe Golden Eagle Yllit. Skuadra pejane është e vetmja në elitë që ka pesë fitore në pesë ndeshje të zhvilluara, andaj pritet një ballafaqim shumë interesant mes këtyre dy skuadrave, që ishin përballur edhe në finale të Kupës edicionin e kaluar, ku triumfuan pejanët. Takimi tjetër i së martës do të zhvillohet në mes të Rahovecit dhe Trepçës. "Vreshtarët" kanë tri fitore dhe dy humbje, kurse mitrovicasit dy

fitore dhe tri humbje, andaj pritet një duel shumë interesant. Të mërkurën do të zhvillohet derbi i qytetit mes Ponte Prizrenit dhe Bashkimit. Takimet mes këtyre dy skuadrave kanë qenë shumë interesante në vitet e fundit dhe kështu pritet të jetë edhe në këtë përballje. Ponte ka dy fitore dhe tri humbje, kurse Bashkimi një fitore dhe katër humbje. Sigal Prishtina pas fitores ndaj Ponte Prizrenit do të ballafaqohet me Vëllaznimin. Prishtinasit kanë dy fitore dhe tri humbje, kurse skuadra kuëzi ka një fitore dhe katër humbje.

PRINCE CAFFÈ SUPERLIGA - JAVA 6

Të martën takohen:

15:00 Peja - Golden Eagle Ylli
15:00 Rahoveci - Trepça

Të mërkurën takohen:

15:00 Ponte Prizreni - Bashkimi
15:00 Sigal Prishtina - Vëllaznimi



Augsburgu tallet me Xhakën

AUGSBURGU, 7 DHJETOR - Granit Xhaka nuk është duke kaluar një moment të mirë te Arsenali dhe ndeshja e fundit kundër Tottenham Hotspur bëri që kritikën të vinin në numër të

lartë. Gjithmonë mesfushori shqiptar ka pasur shumë sulme te "topçinjtë", kjo nisur edhe nga forma e dobët e skuadrës që nuk po njeht rritje prej kohësh. Ndërkohë një prej

tifozëve që dëshironte ulte figurën e Xhakës e ka komentuar në këtë mënyrë: "Xhaka është në nivelin e Augsburgut". Megjithatë goditjen e fundit mesfushorit ia

ka dhënë ekipi gjerman që nuk e pranon këtë krahasim. "Ju lutem, kini pak respekt për ne", shkruhej në faqen zyrtare për të lënë të kuptohet se niveli i Granitit nuk është as për ta.



Marku: Jam krenar që jam pjesë e shfaqjes më të madhe të boksit

LONDËR, 7 DHJETOR - Anthony Joshua më 12 dhjetor do të luftojë për t'i mbrojtur titujt kampion bote ndaj Kubrat Pulev në një mbrëmje të zjarrtë në Londër. Së fundmi mësohet

se pjesë e këtij spektakli do të jetë edhe një kampion nga trojet shqiptare. Florian Marku do të zhvillojë një ndeshje ndaj Alex Fearon në praninë e rreth 1 000 tifozëve. Lajmin e bën të

ditur vetë boksieri nga Lushnja përmes një postimi në rrjetet sociale. "12 dhjetor. Përshëndetje ndjekësit e mi nga e gjithë bota. Ne kemi një luftë këtë të shtunë në

ndeshjen Joshua vs Pulev. Lufta ime do të jetë drejtpërdrejt në 'Skysports' dhe jam krenar që jam pjesë e shfaqjes më të madhe të boksit këtij viti", ka shkruar Marku.



Liga e Kampionëve sjell përballjen Messi - Ronaldo



BARCELONË, 7 DHJETOR - Për herë të parë pas nëntë vitesh, Cristiano Ronaldo dhe Leo Messi përballen sërish në Ligën e Kampionëve. Shorti, problemet fizike, apo së fundmi edhe Covid-19 na kishin privuar nga një sfidë e tillë. Të shohësh CR7 përballë "pleshtit" është gjithnjë një kënaqësi e veçantë, pavarësisht prej rrethanave apo kushteve, e tillë është dhe sfida e së martës, ku të dy ekipet kanë siguruar kualifikimin për në fazën e 1/8, por për sa kohë janë në fushë dy lojtarët më të mirë në botë premtojnë rivalitet. Juventus dhe Ronaldo kanë një arsye më shumë për të kërkuar më të mirën në "Camp Nou", e vetmja mënyrë për ta marrë kreun e grupit G është të fitojnë në Barcelonë dhe këtë duhet ta bëjnë me 3 gola dallim.


"Zonja e Vjetër" shpreson shumë që Ronaldo të jetë në version e tij më të mirë, në 20 ndeshje kundër Barcelonës ka shënuar 15 gola. "Bardhezinjtë" nuk fitojnë një ndeshje në "Camp Nou" që nga viti 2013, por më shumë sesa një sfidë Barcelona-Juve kjo është një sfidë Messi kundër Ronaldos. Ndeshja tjetër në Grupi G është mes 21:00 Dynamo Kyiv dhe Ferencvaros. Këto dy klube kanë grumbulluar nga një pikë dhe luajnë për kualifikim në Ligën e Evropës.

Edhe Grupi H është interesant për faktin se tri klube kanë pikë të barabarta dhe kërkojnë kualifikimin. PSG-ja me fitore ndaj Basaksehirit do të jetë në fazën tjetër, kurse Unitedit i mjafton një pikë ndaj Leipzigit për ta arritur kualifikimin.

GRUPI E		
21:00 Chelsea - Krasnodar		
21:00 Rennes - Sevilla		
Tabela		
1. Chelsea	5	13
2. Sevilla	5	10
3. Krasnodar	5	4
4. Rennes	5	1
GRUPI F		
18:55 Lazio - Club Brugge		
18:55 Zenit - Borussia D.		
Tabela		
1. Dortmund	5	10
2. Lazio	5	9
3. Club Brugge	5	7
4. Zenit	5	1
GRUPI G		
21:00 Barcelona - Juventus		
21:00 Dynamo Kyiv - Ferencvaros		
Tabela		
1. Barcelona	5	15
2. Juventus	5	12
3. Dynamo Kyiv	5	1
4. Ferencvaros	5	1
GRUPI H		
21:00 PSG - I.Basaksehir		
21:00 Leipzig - Manchester U.		
Tabela		
1. United	5	9
2. PSG	5	9
3. Leipzig	5	9
4. Istanbul B.	5	3

Djali i Maradonës: Trashëgimia është gjëja e fundit në mendjen time

BUENOS AIRES, 7 DHJETOR - Diego Junior, djali i Diego Armando Maradonas, ka thënë se trashëgimia e ikonës argentinase është gjëja e fundit për të cilën mendon. Legjenda e futbollit botëror ndërroi jetë më 25 nëntor si pasojë e sulmit në zemër, ndërsa ai ka lënë pas vetes pasuri në vlera milionëshe, nga e cila e ka përjashtuar ish-gruan dhe vajzat e tij në testament. Diego Jr. ka lindur në vitin 1986, mirëpo Maradona e pranoi si djalë të tijin në vitin 2007. "Trashëgimia është gjëja e fundit në mendjen time tash. Do të preferoja të isha i uritur gjithë jetën time sesa të përballesha me këtë problem. Ne fëmijët jemi mbledhur bashkë për nder të babait tim. Sot situata është aq e ngatërruar sa që nuk mund të jap një paragjykim dhe, mes të tjerash, është duke u zhvilluar edhe një proces hetimor", ka thënë djali i



Maradonas për "Canale 5". Në ndërkohë, disa fëmijë që pretendojnë se janë të

Maradonas, po i presin rezultatet e testit të ADN-së për të konfirmuar diçka të tillë.

SHKURT

Shukeri do ta vizitojë Kosovën

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kroacisë, Davor Shuker, do ta vizitojë Kosovën. Vizita e kreut të futbollit kroat pritet të ndodhë në fillim të vitit të ardhshëm nëse gjendja me pandeminë përmirësohet. Ai me këtë rast do të jetë mysafir i FFK-së, e ku do të ketë takime edhe me krerët e institucioneve shtetërore, si dhe do të vizitojë një shkollë të futbollit. Shuker, po ashtu, do të ketë edhe një paraqitje para gazetarëve, ku do të flasë për përvojën dhe të arriturat e tij si futbollist dhe si president i federatës kroate, por edhe si anëtar i KE të UEFA-së.

Eminhaziri largohet nga KF Rahoveci

Futbollisti Isa Eminhaziri ka njoftuar se është larguar nga skuadra e Rahovecit. Këtë lajm e ka konfirmuar vet futbollisti nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook". "Ishte kënaqësi që për gjysmësezon ta ndihmoj klubin e zemrës për t'u ngritur drejt rrugës për t'u inkuadruar më lart, por ja që disa individë arrijnë ta ndërpresin ecurinë pozitive të KF Rahovecit me deklaratat tendencioze dhe pa bazë drejt lojtarëve. Nga sot ndaj rrugët me ekipin e zemrës KF Rahoveci", ka shkruar Eminhaziri.

Nëse e merr drejtimin e Realit, Pochettino i dëshiron këta futbollistë

E ardhmja e Zinedine Zidanes mbetet ende e paqartë, përcaktuese pritet të jetë sfida e fundit në Ligën e Kampionëve kundër Borussia Monchengladbachut. Në rast shkarkimi, zëvendësuesi pritet të jetë Pochettino, për këtë nuk kanë asnjë dyshim në Angli. Argentinasi është një dëshirë e vjetër e presidentit Perez, me të në stol madrilenët do të përpiqen të ndërtojnë një ekip të ri, i aftë për t'i rikthyer spanjollët te triumfi. Pavarësisht prej krizës financiare, sipas mediave angleze, Pochettino ka përpiluar edhe një listë dëshirash. Pëlqimi i parë është Paolo Dybala. Në listën e Pochettinos janë dhe dy emra të tjerë të rëndësishëm, Harry Kane dhe Dele Alli.

IFFHS-ja publikon formacionin e vitit

Federata Ndërkombëtare e Historisë dhe Statistikave e Futbollit (IFFHS) ka zgjedhur formacionin ideal të vitit 2020. Njëmbëdhjetëshi i zgjedhur dominohet nga lojtarët e Bayern Munchen (që fituan tripletën) dhe Liverpoolit (që triumfuan në Premierë Ligën). La Liga përfaqësohet me dy lojtarë, Lionel Messi (Barcelona) dhe Sergio Ramos (Real Madrid), ndërsa Cristiano Ronaldo (Juventus) është i vetmi nga Seria A. Formacioni: Manuel Neuer, Trent Alexander-Arnold, Virgil Van Dijk, Sergio Ramos, Alphonso Davies, Joshua Kimmich, Thiago Alcantara, Kevin De Bruyne, Lionel Messi, Robert Lewandowski, Cristiano Ronaldo. Trajner: Hansi Flick (Bayern Munich).

Pjaniq: Nuk jam i lumtur te Barça, Juve më ka mbetur në zemër

Mesfushori Miralem Pjaniq pas tre muajsh në skuadrën e Barcelonës është penduar që u transferua në këtë klub, pasi shumë ndeshje po i përcjell në rolin e spektatorit. "Do të doje të luaje më shumë? Po, është ajo që unë dëshiroj. Sinqerisht nuk arrij ta kuptoj arsyen e kësaj situatë. Është e qartë që dëshiroj të luaj më shumë. Di të jap akoma më shumë, dhe kur trajneri më ka thirrur, gjithmonë i jam përgjigjur, kam bërë mirë dhe kam luajtur ndeshje të mira. Më shumë se kaq nuk di se çfarë duhet të bëj. Jam duke u stërvitur dhe ndihem gati", ka thënë Pjaniq. "Juventus më ka mbetur në zemër. E ndjek gjithmonë kur mundem. Shorti më bëri shumë të lumtur, keqardhje që nuk mund të luhej me tifozë në Torino, por do të ketë raste të tjera", ka shtuar Pjaniq.



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E SUHAREKËS
 OPSTINE SUVA REKA
 MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Drejtoria e Arsimit
 05nr. 1914
 Datë: 07.12.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L- 212, nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L- 032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ nr. 19/2018, Udhëzimit Administrativ nr.18/2009 dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria e Arsimit shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

- SHMP "Abdyl Ramaj" në Shirokë:**
 -Vendi i punës: Një mësimdhënës/e për lëndë të ekonomisë,
 Kohëzgjatja e kontratës :Deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë.
 Kualifikimi: Përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.5/2015
 - Vendi i punës: Zyrtar/e financiar/e- Kontabilist/e (me plotësim norme ne gjimnazin "Jeta e Re" Suharekë)
 Paga Mujore :Koeficienti 6.6
 Kohëzgjatja e kontratës : Për periudhë të pacaktuar me orar të plotë
 Periudha provuese: Gjashtë muaj
 Kualifikimi : Fakulteti Ekonomik ,drejtimi- Banka ,Financa e Kontabilitet
- Gjimnazi " Jeta e Re " në Suharekë**
 - Një punëtor/e teknik.
 Paga Mujore :Koeficienti 4
 Kohëzgjatja e kontratës :Për periudhë të caktuar me orar të plotë
 Periudha provuese: Gjashtë muaj
 Kualifikimi : Shkolla e mesme
- SHFMU "Drita " në Gelancë**
 - Një mësimdhënës për Qendrën mësimore në Gelancë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit(kërkesa)të cilën e plotëson kandidati
- Diplomat e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj(fotokopje).
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës (nëse ka)
- Dëshmi (certifikata) për aftësim profesional
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHT(nëse ka)

-Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës. Afati i konkurimit 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.
Për orarin e intervistimit do të informoheni në web faqen e Komunës së Suharekës dhe tabelës së shpalljeve të DKA-së.


 Drejtori i DKA-së
 Renzi Bajelmari



Lume's Details

Estetik & Depilim





044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Qullat, Rr. Bajram Kelmendi



Shqiptarë Humanitare Bëmirëse e Kosovës "Mina Teresa"
 The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
 Humanitare Dëshmorëve Udhëzime Kosovë "Maja Teresa"
 10-000 Prishtinë Rr. ULPIANA 113 po. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
 Web site: www.materesociety.org e mail:materesociety@yahoo.com

CONTRACT AWARD NOTICE

SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 07/12/2020

Procurement No	Assesment	001	2020	221
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town:Prishtina	Postal code:10000	Country:Kosovo
Contact point(s): Zef Shala		Telephone:044-128-277
Email:zefshala@hotmail.com		Fax:038-542-865
Internet address (if applicable):		www.matherteresociety.org

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Need Assesment for 400 previous beneficiaries	
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)	
	<input type="checkbox"/> Services
Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities	
II.1.4) Short description of the object of the contract Need Assesment for 400 previous beneficiaries	
II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) 93.000.000.-8 <input type="checkbox"/>	

Standard Form "Contract Award Notice" 1

II.1.6) Division into lots	No <input type="checkbox"/>
II.1.7) Contract value: 16,000.00	

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

III.2) AWARD CRITERIA

<input type="checkbox"/> Lowest price

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award 05/12/2020		
IV.2) Intended date of contract signing 15/12/2020		
IV.3) Number of received tenders 4		
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded		
Official name: "Smart Inovation Centre" Prishtinë		
Postal address: 10000 Prishtinë		
Town:Prishtinë	Postal code:10000	Country: Kosovo
URL (if applicable):		
Contact point(s): Agnesa Morina		Email: info@sic-ks.com
Telephone:045817477		Fax:

IV.5) Information on value of contract	
Total final value of contract 16,000.00 Euro	
Responsive tender with lowest price: 16,000.00 Euro	
Responsive tender with highest price:17,200.00 Euro	
IV.6) The contract is likely to be subcontracted	No <input type="checkbox"/>

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092 ,at the address specified in Section I of this Contract award notice.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "2 Korriku" Sh.p.k Saponicë, Kaçanik, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndryshimin e kapacitetit nga 1.3 MW në 3.75 MW të hidrocentralit në lumin Lepenc komuna e Kaçanikut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.12.2020 në ora 10:00 në hapësirat e parcelës Nr 17. e cila është në mes të punishtes, Rr. "Kongresi Manastirit" fshati Saponicë, Kaçanik do të organizohet debat publik nga kompania "2 Korriku" Sh.p.k Saponicë, Kaçanik, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndryshimin e kapacitetit nga 1.3 MW në 3.75 MW të hidrocentralit në lumin Lepenc komuna e Kaçanikut.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/82621596220?pwd=QINsQTBxMERaRU04cGhYWZuTElWQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "2 Korriku" Sh.p.k Saponicë, Kaçanik për ndryshimin e kapacitetit nga 1.3 MW në 3.75 MW të hidrocentralit në lumin Lepenc komuna e Kaçanikut.

https://mmp.h.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
K.R.M. "ÇABRATI"

Tel. +381(0)380/321 888
+381(0)380/324 034
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakovë

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nënën 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212) dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, dhe Vendimit Nr 1834 të datës 07.12.2020 të Kryeshefi Ekzekutiv, u vendos që me datë 08.12.2020 të shpallët:

Konkurs publik

Për këtë pozitë

I. 1 /një/ **INKASANTË-E** me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1 /një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi, por që 6/ gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese.

Kushtet:

Të posedojnë nivelin e shkollimit: Shkollë e Mesme preferohet drejtimi ekonomik, të ketë më së paku 1 (një) vite përvojë të punës relevante, të ketë aftësi të mira psikofizike për punë me ngarkesa dhe përballje me kushtet në terren që kërkon vendi i punës, preferohet posedimi i patentë shoferit me "B" kategori më së paku, të mos jetë i dënuar apo nën hetime

Kushtet e veçanta:

Të ketë aftësi të mira psikofizike të punës, puna kryhet me ngarkesa shtesë të detyrave të punës dhe në vende të ndryshme në terrene varësisht nga nevoja e punëdhënësit dhe mundësi të ndërrimit të vendit të punës për pozitë ekuivalente. Varësisht nga verifikimi dhe performanca e punës së tij do t'i vazhdohet apo do t'i ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma, Referenca e përvojës 1 (një) vit në punët relevante, të posedoj patentë shoferin me "B" kategori, Raport mjekësor se posedon aftësi të mira shëndetësore për pozitën që konkurren, Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i/e dënuar (më e re se gjatë muaj) dhe Letër Njoftimi.

Detyrat e punës: **Për të dy pozitë ato mund t'i gjeni në veb faqen e kompanisë cabrati.com**

Afati i paraqitjes së kërkesave për të dy pozitë është 15 ditë nga dita e publikimit, (nga data 08.12.2020 e deri me datë 22.12.2020 ora 16:00).

Kërkesën me dokumentacionin e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek sekretaria- Udh. Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë. Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së të testit dhe intervistës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Reklamoje" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811361807 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Reklamoje" DO.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811361807, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Reklamoje" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811361807 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Arra-KS" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. fis. 601612139 nr. biz. 71264823 dhe nr. TVSH-së, 330320143.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

Kur fakti politik bëhet pjesë e historisë, e në e vëzhgojmë atë me një distancë të ftohtë, Xhevdet Bajraj na e shpërndan atë të konvertuar në një fabul të shkëlqyer. *Cuando el hecho político pasa a formar parte de la Historia, y lo observamos con fría distancia, Xhevdet Bajraj nos lo entrega convertido en una espléndida fábula*

Héctor Carreto, poet, meksikan. - *Poeta mexicano*

Imazhet që ai evokon janë të pastra dhe të bukura, me pak njerëz, si plagë të thella e të pastra. Kur përktheja këto imazhe unë u përpoqa ta kap pafajësinë e tyre, bukurinë e tyre fëmijërore, e cila bie kaq shumë në kontrast me makthe të errëta të kujtesës së Bajrajt

Las imágenes que evoca son limpias y hermosas, con poca gente, como heridas profundas y limpias. Al traducir estas imágenes, intenté capturar su inocencia, su belleza infantil, que contrastan de manera tan marcada con las oscuras pesadillas de la memoria de Bajraj

Alice Whitmore, përkthyesë e poezisë së Bajrajt nga gjuha spanjolle në angleze, Australi. - *Traductora de la poesía de Bajrajt del español al inglés, Australia*

Zëri që na detyron t'i modifikojmë kategoritë tona dhe referencat ndaj dhunës, tmerrit, vdekjes, braktisjes, vetmisë, e cila në këtë Amerikën tonë Latine (kaq e prirë për të shpallur dhimbje që nga heroina e romantizmit) ka qenë pretexti i poezisë pamfletuese të oportunitetit lirik

Voz que nos obliga a modificar nuestras categorías y referencias para con la violencia, el horror, la muerte, el abandono, la soledad, que en esta nuestra Latinoamérica (tan proclive a enunciar el dolor desde la heroína del romanticismo) ha sido pretexto de panfletarias poéticas de oportunismos líricos

Carlos Pineda, poet dhe eseist meksikan. - *Poeta y ensayista mexicano*

Poezia e Xhevdet Bajrajt nxit stuhi asociacionesh të lexuesit, e shkëput atë nga realiteti trivial dhe e strehon në një realitet të ri ku mbretëron meditimi për çështje substanciale të jetës, për botën, vetminë, dhimbjen dhe rrugëtimin e njeriut në jetë

La poesía de Xhevdet Bajrajt estimula la tormenta de asociaciones en el lector, lo separa de la realidad trivial y lo cobija en una nueva realidad donde reina la meditación sobre cuestiones sustanciales de la vida, sobre el mundo, la soledad, el dolor y el viaje del hombre en la vida

Zyrafete Shala, kritike letrare. - *Crítica literaria*

Poezi e dinjitetit mbi gërmadha. - *Poesía de dignidad sobre ruinas.*
Shqiptar Oseku, poet. - *Poeta*

6⁹⁹ €

9 789951 780094

KAFÉ ME NËNËN
CAFÉ CON MAMÁ

XHEVDET BAJRAJ



XHEVDET BAJRAJ

KAFÉ ME NËNËN poeziCAFÉ CON MAMÁ poesia

Parathënien/ Prólogo: Adil Olluri



Adem Gashi (1953), poet, prozator dhe eseist, pa lënë mënjane njohuritë e paskajshme të tij për letërsinë shqiptare dhe për atë botërore, ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar mësues dhe ka qenë redaktor

reviste, drejtor televizionit, themelues i PEN-it të Kosovës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bursist i fondacionit gjerman "Heinrich Böll-Stiftung", këshilltar i lartë politik, drejtor i Zyrës për Komunikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Është anëtar i revistës *Akademia* dhe anëtar i Këshillit Drejtues i Institutit Albanologjik. Ka botuar 24 libra dhe është nderuar me rreth 50 çmime letrare. Është prezantuar në dhjetë antologji të lirikës shqipe. Edhe pse që dy vjet ka mbushur moshën e pensionistit, krijimtarinë letrare s'ka ndër mend ta pensionojë.

Libri i katërt me tregime, me rrëfenja e me parabola i Adem Gashit, *Lakorja e fatit*, dëshmon dhe ridëshmon autorin si krijues po aq të fuqishëm edhe në prozë. Madje tani mund të vlerësohet se toka e begatë e shkrimtarit, në kuptimin cilësor të vlerave artistike dhe të hijeshisë dhe të kënaqësisë estetike, është tregimtaria.

Lakorja e fatit çilet me tregimin uverturë *Pëllumbi i paqes* i rimarrë nga libri me titullin omonim (*Pëllumbi i paqes*, 1989), për të lakuar strukturalisht tre kapitujt pasues: *Terr, Dritë dhe mjegull* dhe *Matanë*, të cilët, në aspektin e konceptimit mbarështrues të tyre, na e vizatojnë kurbën tematike dhe motive, ideore dhe përmbajtësore, filozofike dhe psikanalitike jo vetëm të rrëfimitarëve tregimtarë, por edhe të gjenit krijues të autorit. Në këtë rast, besoj, vlen të veçohen dy aspekte: poetika moderniste me elemente të postmodernizmit dhe gërshetimi i formave dhe zhanreve letrare siç, fjala vjen, i prozës (tregimi, rrëfenjat), i poezisë (një lirikë me dy parabola poetike dhe një rrëfenjë-parabolë) si dhe i dramës, i konceptuar në trajtë të antidramës (*Maja e gishtit të madh të perandorit*).

4⁹⁹ €

9 789951 780087

Dr. Emin Z. Emini

LAKORJA E FATIT

ADEM GASHI

ADEM GASHI

LAKORJA E FATIT
(Tregime, rrëfenja dhe parabola)

Katër muaj pa më të dashurin tonë



Isa Qorraj

(18.9.1960-6.8.2020)

Sa hap dhe mbyll sytë kaluan para nesh, para zemrave tona të thyera e kujtimeve të freskëta, katër muaj pa ty në mesin tonë. Ishin këta muaj të vështirë për ne sepse na rënduan gjendjen shpirtërore teksa ditë e natë ndienim mungesën tënde. E ndiejmë atë edhe në këto çaste sa e shkruajmë këtë përkujtim. E ndiejmë zbrazëtinë e madhe, të pazëvendësueshme, të paharrueshme tënden kudo. Na mungojnë fjalët e mençura me të cilat na edukove dhe na mësove edhe kur ishe në Kosovë, edhe kur ishe larg nesh, në Perëndim. Megjithatë, puna, vepra dhe fjalët tua do të na udhërrëfijnë çdo ditë dhe do të na motivojnë për jetë. Ato i kemi në veshët tanë, në kokat tona, në zemrat tona ashtu siç të kemi ty. Prehu në paqe, engjëll!

E përkujtojnë: Bashkëshortja Eminja; djemtë Mali dhe Arturi; vajza Ardiana; reja Qendresa dhe mbesa Juna.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

